



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D I M

Nr 1 datë 07.07.2011

PËR

MENAXHIMIN E SHFRYTËZIMIT TE ZHAVORREVE PER
NDERTIMIN E RRUGEVE.

Në mbështetje të neneve 6 e 20, të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996, “Për rezervat ujore”, të pikave 1,2 dhe 9 të vendimit nr.1, datë 21.6.2006 “Per reduktimin e shfrytëzimit të zhavorreve dhe rerave në shtreterit e lumenjve” dhe të vendimit nr.3, datë 21.6.2006 “Per rehabilitimin e shtreterve dhe të brigjeve të lumenjve, të demtuara nga shfrytëzimi i inerteve”, të Këshillit Kombëtar të Ujit, me propozimin e ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe ministrit të Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Për nevoja të ndërtimit të segmenteve rrugore, me rëndësi kombëtare dhe rajonale, do të lejohet shfrytëzimi i inerteve lumore, sipas studimeve të kryera nga firmat kontraktore dhe të miratuara nga Këshillat e Baseneve Ujembledhës perkates.
2. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit duhet të paraqesë çdo tre muaj pranë Ministrisë së Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave listën e punëve publike të ndërtimit të rrugëve, që kanë domosdoshmeri shfrytëzimin e inerteve lumore.
3. Subjektet kontraktues për ndërtimin e rrugëve, pas paisjes me leje për furnizimin me zhavorr, do të informojnë me shkrim çdo muaj Ministrinë e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave për sasitë e marra nga lumenjtë, konform preventivit të kontratës, si dhe për punën e bërë për rehabilitimin e zonave të shfrytëzuara.

4. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Këshillat e Baseneve Ujëmbledhëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



SALI BERISHA

ZEVENDES KRYETARI



FATMIR MEDIU